

Punësimi shtëpiak

Kampanja e peticioni për më shumë të drejta

2

14.6. – Dita e grevës së grave

Barazi pagash! Pagë minimale 4000.–! AHVplus!

3

Raportet Zvicër – Kosovë

Aksioni simbolik mirëseardhës dhe apelues

4

Nr. 3 | mund 2013 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Iniciativa popullore AHVplus (sigurimi i pleqërisë dhe trashëgimtarëve+)

Për pensione korrekte të pleqërisë në Zvicrën e pasur



Ata që kanë punuar tërë jetën meritojnë një jetë me dinjitet në pleqëri!

Sigurimi i pleqërisë është ndër të arriturat e të mëdha të Zvicrës. Ky sigurim mundëson që të gjithë të kalojnë me dinjitet moshën e shtyrë. Mirëpo për shumë veta, të cilët kanë punuar tërë jetën e tyre dhe kanë paguar kontribute, sot pensioni i tyre është i pamjaftueshëm. Kjo nuk guxon të ndodhë: Me iniciativën AHVplus pensioni i pleqërisë rritet për 10%.

Kushdo që tërë jetën e vet ka kryer punë të rëndë, duhej që në pleqëri të mund të jetojë nga pensioni. Andaj iniciativa AHVplus kërkon rritjen e pensioneve të pleqërisë. Për këtë ekzistojnë edhe parat e mjaftueshme: Të 20 firmat më të mëdha zvicerane vetëm për një vit nga pjesa e fitimit u kanë paguar aksionarëve 29 miliarda franga, pra Zvicra ka numrin më të madh të milionerëve të botës. Është tërësisht e pabesueshme të deklarohet se nuk ekzistojnë para të mjaftueshme për pensione korrekte. Me tatimin në trashëgimi dhe nëse tatimin duhan dhe alkool plotësisht dedikohet për pensionet e pleqërisë do të financoheshin pensionet e larta.

Financimi i pensioneve të pleqërisë (AHV/AVS) është i drejtë dhe social

Përse të forcohen pensionet e pleqërisë? Ndër të tjera ngase do të financoheshin në mënyrë të drejtë dhe korrekte. Të gjithë të punësuarit,

edhe ata që fitojnë shumë paguajnë nga paga e plotë dhe nga çdo përfitim tjetër shpërblyes në arkën e pensioneve të pleqërisë. Megjithatë pensionet janë të kufizuara: Një çift bashkëshortësh menaxher bankash nuk merr më shumë pension pleqërie se sa një elektrikist dhe bashkëshortja e tij, e cila ka punuar si shitëse. Falë formulës sociale të pensionit rritja e pensioneve të pleqërisë për personat me paga të vogla dhe të mesme shumë e lirë se sa tek format tjera të përkujdesjes së pleqërisë.

Pensionet e fuqishme të pleqërisë i ndihmojnë edhe grave dhe rinisë

Përderisa njerëzit në Zvicër punojnë dhe fitojnë para, ne mund ti paguajmë pensionet e pleqërisë edhe nëse rritet pjesa e popullsisë së moshua. Receta: Pasi shumica e pagave në Zvicër rritet në vazhdimësi, kemi më shumë para për pensionet në posedim. Pensionet e pleqërisë financiar-

risht janë në baraspeshë. Qeveria federale me prognozatat e saj negative doli se gabonte gjithmonë.

Pensionet e fuqishme të pleqërisë i ndihmojnë edhe grave dhe rinisë

Për arsye të lehonisë dhe përkujdesjes së fëmijëve gratë shpesh marrin pensione të ulëta profesionale. Tek pensionet e pleqërisë (AHV/AVS) në të kundërtën ndërprehet e punësimi baraspeshohet falë shpërblimeve edukative. Kështu edhe gratë dhe fëmijët mund të përfitojnë nga pensionet e mira të pleqërisë. Edhe familjet e reja kursejnë me mijëra franga, nëse në vend të kolonës së 3-të, përkujdesjen e pleqërisë e sigurojnë përmes formës së pensionit të pleqërisë (AHV/AVS). Kursimi privat për pleqëri përmes kolonës së 3-të kushton shumë para, pasi janë bankat dhe sigurimet ato që përfitojnë. Janë me rrezik dhe përfitimi është më i ulët.

Andaj po për AHVplus!

Ka 40 vjet që në parim nuk janë përmirësuar pensionet e pleqërisë. Ato çdo dy vite vetëm se janë përshtatë pjesërisht me zhvillimin pagave. Pensionet e pleqërisë kanë çaluar pas

pagave. Andaj përmirësimi është më se i nevojshëm dhe në Zvicrën e pasur edhe real. Iniciativa popullore AHVplus kërkon rritjen e të gjitha pensioneve të pleqërisë (AHV/AVS) për 10%. Rritja do të paguhet si shtesë në pensionet e deritashme të pleqërisë. Përlogaritja e pensioneve të pleqërisë, e cila është treguar e drejtë, nuk do të ndryshojë. Mesatarja e pensioneve të pleqërisë (AHV/AVS) rritet për personat e vetëm për 200 franga, ndërsa për çiftet bashkëshortore për rreth 350 franga.

⇒ Aurora García

Grumbullo edhe ti!

Tani të gjithë janë të ftuar për të kontribuar! Grumbullo edhe ti nënshkrime për iniciativën AHVplus. Për shembull bashkëngjitu klubit 100-të dhe grumbullo 100 nënshkrime për 100 ditë. Grumbulluesit më të vyeshëm mund të fitojnë një pushi fundjave në një nga hotelet e Unia-s. Më shumë informacione mbi iniciativën mund të gjeni tek: www.ahvstaerken.ch www.renforceravs.ch

Editorial



Për paga korrekte e pensione më të mira!

Ne jemi duke jetuar në një kohë dinamike, në të cilën gjithçka shumë shpejt ndryshon – këtu në Zvicër si dhe në tërë botën. Mirëpo problemet pak a shumë kanë mbetur të njëjtat. Bota edhe më tej është e ndarë në të pasur dhe të varfër. Këto gjëra janë duke u zgjeruar gjithnjë më shumë. Në të njëjtën kohë duhet që shumica e shoqërisë, e përbërë nga ata që posedojnë fare pak apo asgjë, ti bartin mbi kurriz të tyre pasojat e lakmisë të së pasurive. Kjo vlen për të gjithë punëmarrësit dhe punëkërkuarit pavarësisht nga ajo se a janë vendës apo ardhacakë, qoftë në Zvicër apo kudo qoftë në botë.

Në Zvicër është duke u intensifikuar lufta për pagat minimale e ankoruara me ligj, për më shumë pensione dhe kundër dumpingut në paga. Gjithashtu janë rritur përpjekjet kundër rrjepësve dhe mbylljes së gërshtëve si dhe për barazinë e pagave. Në Zvicër sikur në të gjithë botën pasanikët dhe spekulantët e të gjitha llojeve me njëri tjetrin janë shumë solidar, jo së fundit për të ruajtur, legjitimuar dhe përforcuar privilegjet dhe fuqinë e tyre. Ne mundemi dhe duhet ti kundërvihemi kësaj, duke u angazhuar bashkërisht në tërë botën për një ekonomi, e cila u shërben njerëzve; për kushte më të mira pune korrekte dhe paga korrekte, të cilat detyrueshëm duhet të jenë të siguruara me Kontratë Kolektive të Punës!

Andaj me 1 maj ne duhet të tregohemi edhe më solidar: «Për paga korrekte, pensione më të mira!». Ne duhet bashkë me sindikatat tona kudo që është e nevojshme bashkërisht të angazhohemi për kushte më të mira pune, për një jetë më të mirë, për drejtësi, barazi dhe të drejta njerëzore!

Osman Osmani

Sekretar sindikal për migracion në Unia

News

Ligji i shtetësisë: planifikohen përkeqësime

Parlamenti zviceran në mes të muajit mars ka debatuar mbi ligjin e shtetësisë dhe me këtë rast ka bërë propozime restriktive. Kontributi i migrantëve në shoqërinë zvicerane edhe më tej nuk pranohet. Rishtas duhet që vetëm migrantët «e integruar mirë» dhe vetëm ata, të cilët mund të «shprehen mirë» në një rreth nga gjuhët zyrtare të vendit, të kenë mundësinë e marrjes së shtetësisë. Pos kësaj rishtas për shtetësi mund të aplikojnë vetëm migrantët me lejen e përhershme të qëndrimit C. Posaçërisht indinjuese është eliminimi i lehtësimit të vetëm që sot kanë migrantët e moshës së re. Kështu vitet mes moshës 10 deri 20 vjeç nuk do të numërohen dyfish. Unia nuk refuzon këtë përkeqësim si të papranueshëm.

Komunikata mbi revidimin e ligjit për të huajt

Në kumtesën e vet qeveria e Zvicrës deklaroi se integrimi nuk është vetëm çështje e migrantëve por edhe e Federatës, Kantoneve dhe Komunave. Se si integrimi duhet të bëhet konkretisht, mbetet edhe më tej e paqartë. Kështu mjetet për masat cytëse mbesin ende të kufizuara. Ngarkesa për mbulimin e shpenzimeve të kontributeve për integrim edhe më tej do të vihen për barrë migrantëve. Për të vlerësuar pozitivisht është fakti se federata heq dorë nga marrëveshjet integruese gjithëpërfshirëse deh të fuqizojë të drejtën për lejen e përhershme të qëndrimit C pas 10 viteve në Zvicër.

Orari i hapur i shitoreve: Është nisur referendumi



Më 3 prill rreth 100 aktivistë kanë dorëzuar dokumentacionin për referendumin kundër orarit 24 orësh të punës. Një aleancë e gjerë e sindikatave dhe organizatave tjera sociale për gati 3 muaj kanë grumbulluar 86 499 nënshkrime mbresëlënëse. Më shumë se gjysma e nënshkrimeve vijnë nga Unia. Logoja e kampanjës (Ora me punëmarrësit si akrepa «tregues») u përdor në mënyrë kreative gjatë aksionit të dorëzimit të nënshkrimeve, gjë që hasi në jehonë tek mediat që ishin prezentë.

Kampanja «Asnjë punonjës shtëpiak nuk është ilegal»

Më shumë të drejta për punonjësit shtëpiak!



Punonjëset nëpër shtëpitë private gjatë protestës kërkojnë të legalizohen

Punonjësit shtëpiak kontribuojnë në shtimin e kualitetit jetësor të njerëzve të panumërt në Zvicër: Ato mundësojnë harmonizimin e jetës profesionale dhe asaj familjare ose angazhimin në profesione ambicioze. Pa migrantët në përgjithësi dhe pa personat pa letra në veçanti ky sektor nuk do të funksiononte. Një koalicion i gjerë i organizatave, të cilit i takon edhe Unia, nisi për këtë në mars kampanjë e cila kërkon nga qeveria që për punonjësit pa leje qëndrimi më shumë të drejta dhe rregullimin e lejes së qëndrimit.

Puna e paguar shtëpiake në Zvicër po bëhet gjithnjë e më shumë e pashmangshme. Kërkesat për fuqi punëtore sa vijnë e rriten. Numri grave që zhvillojnë veprimtari profesionale është duke u rritur dhe për shkak të ndarjes së pabarabartë të punëve të shtëpisë mes burrave e grave dhe mungesa e infrastrukturës së mjaftueshme për përkujdesjen e fëmijëve, shumë gra mund të punojnë vetëm falë ndihmës së punonjësve shtëpiak.

Punët e pastrimit, përkujdesja e fëmijëve apo përkujdesja e prindërve me nevoja gjithnjë e më shumë kryhen nga fuqi punëtore e jashtme.

Pasojë edhe e politikës së jashtme zvicerane

Sektori i punëve shtëpiake ka shënuar rritje të madhe, mirëpo ka shumë parregullsi: Si punëtorët shtëpiak polakë në Tesin, të cilët janë të detyruar t'punojnë në kushte shumë të vështi-

ra dhe të pa dinjitetshme, ashtu edhe punonjësit shtëpiak pa leje pune nga ndonjë shteti tjetër, të cilët jetojnë në ankth të përhershëm se do të dëbohen dhe të cilëve u duhet të pnojnë pa sigurime sociale. Të fundit për shkak të ligjit ekzistues për të huajt, i cili nuk pranon realitetin dhe i cili nisët nga paramendimi se Zvicra nga shtetet e treta ka nevojë vetëm për punëmarrës me kualifikim të lartë, pasi gjoja vendet tjera të punës janë të mbuluar mjaftueshëm nga punëmarrësit që vijnë nga hapësira e BE-së. Rasti me punët shtëpiake tregon se kjo nuk qëndron.

Shumë persona pa letra punonjës shtëpiak

Një pjesë e madhe punonjësve shtëpiak janë gra pa leje të rregulluar qëndrimi. Sipas vlerësimeve të përafërta

mbi 40'000 punonjës shtëpiak janë persona pa leje qëndrimi dhe nga ta 90% janë gra. Shumica kanë disa punëdhënës, mirëpo edhe përkundër kësaj nuk arrijnë të sigurojnë minimumin jetësor të ekzistencës. Nëse punojnë vetëm për një familje sipas rregullit jetojnë në të njëjtën amvisni dhe kështu janë plotësisht të varur nga punëdhënësi. Vetëm pak veta janë të lajmëruar tek siguruar shoqërore nga frika e denoncimit. Kështu ata marri përsipër të gjitha rreziqet (si sëmundja, aksidenti, etj.) dhe nuk kanë mundësi fare të realizojnë të drejtat e tyre si punëmarrës.

Peticioni për më shumë të drejta

Një koalicion i gjerë i organizatave bashkë me sindikatën Unia, lansuan më 15 mars një kampanjë, thelbi i së cilës është peticioni, përmes të cilit i kërkohet qeverisë me shume të drejta për punonjësit shtëpiak pa leje të rregulluar qëndrimi. Posaçërisht duhet të zyrarizohet leja e qëndrimit për punonjësi shtëpiak pa leje qëndrimi. Ata duhet të kenë mbrojtje sociale dhe qasje në gjyqësinë e punës, pa u rrezikuar dëbimin nga Zvicra.

Aurora Garcia

Më shumë informata mund të gjeni në faqen e internetit të kampanjës: www.khii.ch (gjermanisht) www.aemni.ch (frëngjisht) apo www.ncdei.ch (italisht). Aty mund të nënshkruani në mënyrë elektronike peticionin në fjalë. Secili nënshkrim vlen shumë!

Ripërtëritja e KKP për industrinë MEM

Një KKP e fortë për një sektor të fortë të industrisë MEM

Në fund të qershorit 2013 përfundon Kontrata Kolektive e Punës (KKP) për industrinë e Makinave, Elektrike dhe atë të Metalit. Me rastin e bisedimeve për KKP-në e re Unia kërkon pozicionim të qartë për Zvicrën si vendndodhje industriale. Kësaj duhet shtuar edhe fuqizimin e pagave minimale.

Unia kërkon blerjen e një politike aktive industriale, e cila orientohet në shndërrim ekologjik e social. Përmes kësaj mund të krijohen vende pune dhe për të ardhmen e Zvicrës me orientim drejt vendndodhjes industriale.

Me rëndësi pos tjerash është përcaktimi i pagës minimale. «Industria MEM edhe më tej nuk njih pagën minimale obliguese. Kjo mundëson dumpingun dhe shtypjen e pagave. Kështu gjithmonë e më shumë vështirësohet gjetja e stafit pasardhës junior», bënë me dije Corrado Pardini, anëtar i udhëheqjes qendrore të Unia dhe drejtues i sektorit të industrisë.

Jo pagave varfanjake!

Në industrinë e makinave kemi punëmarrës, të cilët punojnë për shumë më pak se sa 3000.- franga, para së gjithash në regjionet kufitare. Pagat minimale janë mjet ndikues kundër kësaj gjendjeje. Ato kujdesen pos tjerash që të gjitha ndërmarjet të përfitojnë njëjtë dhe të mund ti përballojnë konkurrencës mes njëra tjetër. Kjo bënë Zvicrës si vendndodhje industriale më të aftë për konkurrencë.

Kërkesat tjera të Unia-s

Temat tjera të bisedimeve janë: Mbrojtje më e mirë e aktivistëve sindikalistë, pensionimi i parakohshëm me 62 vjet, barazi mes burrit dhe gruas, anulimi i «Nenit 57. mbi krizën». Ky lejon në situata të vështira ekonomike zgjatjen e orarit të punës. Në praktikë kjo zbatohet arbitrarisht dhe bartë krizën në kurriz të punonjësve.

Jo të gjitha organizatat e punëtorëve angazhohen njëjtë

Shumice e organizatave të punëmarrësve kërkojnë shumë më pak se sa



Industria MEM ende nuk njih pagën minimale

Unia. Organizata «Die Angestellten Schweiz» (të punësuarit e Zvicrës) bile janë deklaruar publikisht kundër pagës minimale. Kjo vështirëson bisedimet. Mirëpo Unia e kupton si

detyrë të vetëkuptueshme të saj, që në këtë çështje të ushtrojë edhe më shumë presion.

Marilia Mendes

14 qershori – Dita e grevës së grave

«Barazi pagash! Pagë minimale 4000.-! AHVplus!»



Çdo vit më 14 qershor në ditën e grevës së grave zhvillohen manifestime si në këtë pamje

Si çdo vit festojnë gratë e burrat në tërë Zvicrën më 14 qershor ditën e grevës së grave. Këtë vit Unia do të zhvilloi aksione nëpër regjione të ndryshme, si p.sh. një mbrëmje skare për gra «Barbeculture» me paraqitje kulturore feminist në Bazel. Pasi gratë janë edhe më tej jo proporcionalisht të prekura nga varfëria.

Pagat që nuk sigurojnë ekzistencën e minimumit jetësor janë në pjesë më të madhe pagat e grave. Derisa përqindja e pagave të ulëta të burrave për vitin 2010 ishte 6.1%, tek gratë kjo përqindje arriti deri 15.8%. Sipas një studimi të eurostat Zvicra është nga vendet e pakta ku gratë gati tri herë më shpesh janë të prekura nga pagat e ulëta. Kuota e varfërisë tek gratë është dyfish më e lartë se sa tek burrat. Posaçërisht janë të prekura gratë vetë mbajtëse të familjes. Nën kushtet e këqija financiare të grave


nuk vuajnë vetëm gratë, por edhe posaçërisht edhe fëmijët e tyre.

Pagat minimale: një hap drejt barazisë në paga

Zvicra çalon sa i përket pabarazisë në paga mes gjinive që është në kundërshtim edhe me obligimin kushtetues. Pa pagën minimale edhe në vitet e ardhshme nuk do të kemi ndryshime të qëndrueshme. Përvoja nga Anglia tregon se dallimet në paga mes burrave dhe grave me zbatimin e pagës minimale janë zvogëluar duk-

shëm. Pagat e ulëta ndikojnë edhe në pensione: Gratë janë shumë më të prekura nga pensionet që nuk sigurojnë ekzistencën. Andaj për këtë arsye Unia mbështetë iniciativën AHVplus, e cila parashih rritjen e të gjitha pensioneve të pleqërisë (AHV) për 10%. Kështu edhe gratë e Unia-s në vitin 2013 kërkojnë: «Barazi pagash! Pagë minimale 4000.-! AHVplus!»

⇒ Aurora García



Referendumi kundër revidimit të ligjit për azil

Jo përkeqësimit të ligjit për azil më 9 qershor!

Më 9 qershor do të votohet për ligjin restriktiv për azil. Ndryshimet ligjore drejtohen drejtpërsëdrejti kundër kërkuesve të azilit, të cilët kërkojnë një vend të sigurt, për të mos jetuar me frikë nga vdekja. Me një JO më 9 qershor vihet shenjë përkritazi me të drejtat njerëzore.

Posaçërisht dy ndryshime janë të vështira. Eliminimi i procedurës nëpër ambasada, pra heqja e mundësisë për të shtruar kërkesë për azil në njërin nga Ambasadat e Zvicrës, do të qojë në atë që personat me nevoja dhe posaçme mbrojtëse si gratë dhe fëmijët, detyrohen të ndër marrin organizime të rrezikshme udhëtimi me banda klandestine – shumë nga të cilët vdesin gjatë një udhëtimi të tillë. Pos kësaj refuzimi i pjesëmarrjes në luftë është eliminuar si arsye azili, gjë që nuk është në përputhje me të drejtën e popujve si dhe nuk është e drejtë për mbajtësit. Njerëz të ri në atdheun e tyre janë të detyruar të marrin pjesë në konflikte të armatosura shumëvjeçare dhe mizore. Refuzimi i shërbimit në luftë shpesh është e vetmja rrugë për të bërë një jetë me dinjitet ju duhet të ikin nga vendlindja e tyre, pasi që ndiqen si tradhtar të vendit.



Duhet votuar JO, kundër përkeqësimeve në lëmin e azilit

JO më 9 qershor

Komiteti i referendumit – Unia është anëtar i këtij komiteti – nuk pajtohet me revizionin në fjalë dhe për këtë arsye kanë zgjedhë rrugën e referendumit. Kjo është shenja e vetme që mund të vejmë kundër paturpësisë politike të borgjezisë në kurriz të refugjatëve dhe kërkues-

ve të azilit. Referendumi drejtohet kundër një politike marginalizimi dhe stigmatizimi. Unia fton të gjithë që të qesin një JO në kutitë votuese: Duhet thënë JO këtyre ndryshimeve, qoftë si humanist/e, si demokrat/e apo si avokat/e e barazisë juridike.

⇒ Emine Sariaslan

Intervistë



Përfaqësuesit e Unia-s në WSF, Giovanni Giarrara dhe Camila Aros

Intervista WSF (forumi social botëror) 2013 Tunizi

«Një botë tjetër më e mirë, është e mundshme»

Nga 26. – 30. mars 2013 u zhvillua forumi botëror social (në tekstin e mëtejme WSF) në Tunizi me moton «Dignity» (Dinjtet në anglisht), për të vlerësuar pranverën arabe.

WSF-ja e parë u mbajt më 2001 në Porto Alegre të Brazilit, si kundër-manifestim i forumit ekonomik botëror (WEF) mbajtur në Davos të Zvicrës. Që nga kjo kohë është zhvilluar më tej, mirëpo i mbeti besnike detyrës kryesore: një hapësirë për aktivitete vetëqeverisëse. Kjo i jep WSF-së një shpirt dhe hapësirë kreative dhe improvizuese për të diskutuar në mënyra dhe forma të ndryshme për tema të ndryshme. Gjatë forumit takohen deri në 100 grupe punuese në ditë dhe krahas kësaj edhe shumë manifestime. Mirëpo të gjitha këto zhvillohen bazuar në idenë, se është mundur një botë tjetër, një formë shoqërore jo kapitaliste.

Në ditën e fundit Horizonte ka zhvilluar një bisedë me dy përfaqësues të delegacionit të Unia-s. Camila Aros, anëtare aktive e bazës nga grupi i interesit për rini dhe grupit të interesit për migracion nga Gjeneva si dhe Giovanni Giarrara, bashkëkryetarë i komisionit për migracion të Unia-s, shpjegojnë në vijim përshtypjet e tyre.

Me cilat pritje keni marrë pjesë në WSF?

Camila: Unia e Gjenevës paraprakisht ka përgatitur pjesëmarrjen dhe qëllimisht ka përzgjedhur dy përfaqësues nga radhët e rinisë. Kështu na na u dha shansi të mësojmë risi dhe të krijojmë përvoja të reja – ishte kjo pjesëmarrja ime e parë në WSF. Ne u nisëm më një detyrë konkrete: Ne u takuam me përfaqësues lokal të sindikatave, për të vu kontaktet e para. Pos tjerash unë doja të shihja si përjetoj rinia tuniziane dhe shoqëria civile revolucionin dhe kohën «pas revolucionare» si deh të mësojmë për angazhimin e saj gjatë kësaj kohe.

Giovanni: Është hera e katërt që marrë pjesë në WSF. Unë doja gjithsesi të mësoja për situatën në Tunizi, të njihem me realitetin e tunizianëve, për tu shpjeguar më pastaj të tjerëve në Zvicër.

Nëse janë përmbushur pritjet e juaja, për sa janë përmbushur ato?

Giovanni: Organizimi i WSF-së ka qenë super. Në demonstrimin me rastin e hapjes ishte një atmosferë pozitive dhe paqësore, me slogane shumë të mira. Mirëpo unë u pikëllova kur në kamp pashë listën e gjatë e të vrarëve. Mbi 16 500 njerëz vdiqën me rastin kur provuan ta kalojnë detin Mesdhe për të arritur në Evropë. Më kanë lënë përshtypje nënat e tyre, ato nuk dijnë as sot për fëmijët e tyre dhe kërkojnë nga qeveritë që të veprojnë. Shumë nga këta fëmijë fshihen si duket edhe nga turpi.

Camila: WSF-ja ishte një rast i shkëlqyeshëm për tu takuar me përfaqësues të organizatave tjera, posaçërisht me sindikata tjera. Mua më kanë lënë përshtypje të forta të rinjtë tunizianë! Si e sa angazhohen ata në aktivitetet politike dhe kaq të ri! Ata janë pjesërisht 15 deri 20 vjeç dhe të ndikuar dhe të politizuar fortë nga revolucionin. Mirëpo ata kanë paguar një çmim të lartë për lirinë – ata kanë humbur shumë njerëz të dashur. Takimet me sindikalistë tjerë, veçanërisht me SAPAP-in algjerian më ka bërë të vetëdijshëm, se në shumë vende puna sindikaliste është a pamundur. Detyra e jonë si sindikalistë internacionalistë është ti mbështesim ata.

Çka do të veçonit ju nga përmbajtja e grupeve të punës?

Giovanni: Unë natyrisht kam përzgjedhur grupet e punës që kanë të bëjnë me migracionin. Mirëpo njeriu duhet të zgjerojë horizontin e tij dhe për shembull kam vizituar edhe një grup pune ku është diskutuar për reformën e OKB-së. Si kulm i tërë kësaj ishte kuvendi i konvergencës së migrantëve, me çrast ne kemi vendosur të ftojmë një grevë me të gjithë migrantët në tërë botën.

Camila: Në të dy, «e reja dhe i moshuari», duam të falënderojmë Unian që na mundësoi këtë përvojë! Për bukë, liri, dinjtet ashtu si këndonin tunizianët e rijë. Ose thënë ndryshe: Për atë që mundëson plotësimin e ëndrrave dhe një botë tjetër!

⇒ Aurora García

Marrëdhëniet Zvicër-Kosovë, Prishtinë, 2 prill 2013

Vizitë zyrtare e parlamentarëve zviceran në Kosovë

Një delegacion zyrtar i Parlamentit Zviceran, kryesuar nga kryetarja e Këshillit Nacional dhe e Kuvendit Federal të Zvicrës, z. Maya Graf, po qëndron për një vizitë ka-tërditëshe zyrtare në Kosovë nga 1 deri më 4 prill 2013.



Aksioni simbolik para delegacionit parlamentar zviceran

Të martën, më 2 prill u zhvillua takimi në mes të dy delegacioneve të Kosovës dhe Zvicrës të kryesuar nga kryepalamentarit Jakup Krasniqi dhe kryeparlamentares Maya Graf.

Znj. Maya Graf me delegacionin zviceran u takua edhe me Komisionin për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës, të kryesuar nga z. Albin Kurti. Më pastaj delegacioni parlamentar zviceran u takuan edhe me përfaqësues të minoriteteve, si dhe në një takim të posaçëm edhe me Avokatin e Popullit, z. Sami Kurteshin.

Aksion simbolik mirëseardhës dhe apelues

Po të martën me 2 prill 2013, aty a dreka duke shfrytëzuar na vizita zyrtare e parlamentarëve zviceran nga pensionistët e Zvicrës që janë kthyer në Kosovë dhe familjarëve të tyre, të mbështetur nga sekretari për migracion i sindikatës Unia të Zvicrës, Osman Osmani dhe përfaqësues të sindikatave të Kosovës si dhe nga Lëvizja Studentore për Barazi – Studim Kritik Veprim, zhvilluan një aksion simbolik për të protestuar për mos vijimin e zbatimit të Marrëveshjes për sigurimet shoqërore tash e tri vjet. Grup i studenteve dhe studentëve nga Lëvizja Studentore për Barazi «Studim Kritik Veprim», u deklaruan se solidarizohen me pensionistët dhe familjarët e tyre, duke bërë të qartë se problemet brenda një kategorie të shoqërisë janë probleme të të gjithë shoqërisë dhe se ata angazhohemi që ti luftojmë këto padrejtësi.

Me aksionin simbolik në fjalë u solidarizuan edhe drejtues të sindikatave të Kosovës, si nënkryetari i BSPK-së Alush Sejdiu me bashkëpunëtorë dhe Hasan Abazi, kryetari sindikatave të metalistëve të Kosovës.

Ata pritën parlamentarët zviceran me një transparent mirëseardhës dhe apelues ku në të dy gjuhët, në gjermanisht dhe shqip me këtë përmbajtje: «Zviceranët janë gjithmonë përzemërsisht të mirëseardhur në Kosovë! Pensionet tona zvicerane gjithashtu! Ne jemi duke pritur.» Anëtarëve të delegacionit parlamentar zviceran iu dorëzua edhe shkresa të cilën po e botojmë në vijim:

Punëtorët e kthyer nga Zvicra në Kosovë dhe familjarët e tyre, të mbështetur edhe nga sindikalistë të Kosovës dhe të Zvicrës si dhe nga Lëvizja Studentore për Barazi – Studim Kritik Veprim.

Prilli i zi dhe i padrejtë për pensionistët e Kosovës nga Zvicra

Dje janë mbushur 3 vite të plota që nga dita kur nuk gjen zbatim Marrëveshja mbi Sigurimet të dalë shoqërore me shtetin më të ri të Evropës – Republikën e Kosovës si shtetin e vetëm nga ish Jugosllavia dhe Zvicrës. Me vendimin për të mos vazhduar Marrëveshjen dhe për të mos paguar pensionet e pleqërisë, shtesat familjar dhe pensionet e invaliditetit në Kosovë, diskriminohen me mijëra punëmarrës nga Kosova, të cilët për shumë vite – disa nga ta edhe për gjysmë shekulli kanë punuar në Zvicër.

Në fillim të viteve të 60 Zvicra pat rekrutuar shume punëtorë për kantiert, restorantet dhe ndërmarrjet bujqësore punëtorë sezone të cilët më vonë morën leje qëndrimi vjetore dhe dikur edhe leje të përhershme qëndrimi në Zvicër. Shpesh shumë vit më vonë përmes bashkimit familjar në Zvicër shkuan edhe gratë e fëmijët të këtyre punëtorëve. Në ndërkohë gati secili banorë i 40-të është i ardhur nga Kosova. Së paku çdo i dhjeti banor i Kosovës jeto në Zvicër. Sot pas 50 vjetësh gjithnjë e më shumë nga këta punëtorë arrijnë moshën e pensionit dhe një numër i konsiderueshëm dëshirojnë që moshën e tyre të pensionit ta kalojnë në Atdheun e tyre. Shumë fëmijë të këtyre punëtorëve nuk kanë aplikuar për bashkim familjar dhe në Kosovë varen nga shtesat familjare.

Vendimi për mos vazhdimin e zbatimit të Marrëveshjes në fjalë në raport me Kosovën është padrejtë për të gjithë këta njerëz, që kanë kontribuar për zhvillimin ekonomi të Zvicrës. Ndërsa nga aspekti financiar dhe ai socio-politik në masë të caktuar edhe më i shtrenjtë. Derisa pensionet e ulëta do të mjaftoni për të zhvilluar jetë të mirë e me korrektësi në Kosovë, ato atyre në Zvicër nuk do tu mjaftonin dhe do të duhej të merrnin mbështetje shtesë. Posaçërisht nëse nga një pension duhet të jetojë një familje e tërë.

Punëtorët dhe punëtorët e Kosovës që kanë punuar në Zvicër dhe tani më janë kthyer në Kosovë dhe kanë arritur moshën e pensionit, në vend të pensionit marrin një pagesë të njëhershme, e cila është shumë më

e ulët se sa vlera e pensionit. Gjyqi administrativ federal i Zvicrës ka vendos që pagesat e njëhershme kesh të kontributeve të shtyllës së parë të pensioneve të pleqërisë në vend të pensioneve është i paligjshëm.

Kontributpaguesit tanë të viktimizuar nga zyrtarët e të dyja vendeve

Paguesit e kontributeve nuk duhet dhe nuk guxojnë të jenë viktimat e pengesave komunikuese të zyrtarëve apo të vështirësive të zbatimit dhe për këtë shkak pas shume vitesh pune të vështirë tani kur duhet të gëzojnë pensionet e tyre të pleqërisë edhe të dënohen. Nuk është në rregull që njerëzit nga Kosova të gjobiten për shkak se dy shtetet, Zvicra dhe Kosova, si duket nuk janë në gjendje të rregullojnë problemet që kanë të bëjnë me zbatimin e Marrëveshjes.

Zyrtarët e të dyja palëve duhet që të veprojnë në interes të njerëzve të prekur dhe përfundimisht e shpejtë të veprojnë e të gjejnë zgjedhje. Pensionistët e prekur të Kosovës, të cilët kanë punuar në Zvicër dhe kanë paguar kontributet e tyre sociale, presin nga Zvicra që ajo ti jep fund kësaj situatë të pa dinjitetshme dhe që qytetarët e prekur të Republikës së Kosovës të mos tua stërgjatin edhe më tej përfitimin nga pensionet e tyre plotësisht të merituar!

Në i ftojme të dy qeveritë në Bernë dhe në Prishtinë si dhe të gjithë përgjegjësit politik në Zvicër dhe Kosovë të vlerësojnë seriozitetin e situatës dhe të angazhohen në mënyrë konsekuente për një Marrëveshje të re të Sigurimeve Shoqërore. Deri atëherë duhet të gjejë zbatim Marrëveshja e vjetër.

Ne shpresojmë në mbështetjen e Juaj!

⇒ Rexhep Rifati, Prishtinë, 2 prill 2013



Sensibilizohen parlamentarët



Kryetarja e parlamentit e interesuar



Dëshmia aktuale e punës: A guxon të ma mohojë ndërmarrja ime?

Shefja ime pensionohet në fund të verës, andaj unë i kam kërkuar një dëshmi punë aktuale. Më pas unë jam ftuar për një bisedë: Ajo kërkon arsyetimin përse unë dua të kem dëshminë aktuale të punës. A ka ajo të drejtë të kërkojë diç të tillë?

Jo. Ju keni në çdo kohë të drejtë që të kërkonit një dëshmi pune, pra edhe një dëshmi edhe gjatë kohës që jeni në marrëdhënie të punës. Arsyetime pse ju doni Diç të tillë nuk është i nevojshëm. Është këshillueshme që diç të tillë të kërkonit kur ndërrohen shefat. Shefja juaj aktuale e din më së miri cilën veprimtari keni zhvilluar dhe mund të vlerësojë edhe kontributin tuaj në kuadër të veprimtarisë suaj punuese. Nëse lëshoni punën menjëherë pas shefes suaj, shefat e ri tuaj nuk do të mund të lëshonin dëshmi të besueshme e vlerësuese të veprimtarisë dhe kontributit tuaj: Koha do të ishte e shkurtë. Sa i përket formës dhe përmbajtjes dëshmia aktuale e punës përbënë të njëjtat të dhëna sikur dëshmia vlerësuese e plotë.

Heinrich Nydegger, work, 25.8.2011

Rezervimi i shtëpisë: A mund të tërheq parat e përkujdesjes të pensionit profesional?

Gruaja ime dhe unë duam të blejmë një shtëpi. Mirëpo shtëpia e ëndrrave tona ende nuk është ndërtuar. Arkitekti është i gatshëm të na e rezervojë këtë shtëpi, mirëpo për këtë kërkon 30 000 franga. Çmimi e vërtetë ne duhet të fillojmë ta paguajmë në rata posa të bëjmë nënshkrimin e shitblerjes. Ne për të blerë shtëpinë duam të përdorim përfitimet nga shtylla e dytë e sigurimit të pensionit profesional të gruas sime. A mund ti përdorim ne për rezervimin këto para të sigurimit profesional të pensionit?

Jo. Marrja e parakohshme ose deponimi garantues i mjeteve të mjeteve të kursyera nga sigurimi profesional i pensionit është e lejueshme vetëm për pronësinë banesore për nevojat personale. Domethënë për përdorim nga personi i siguruar në vendbanimin e tij apo në «vendqëndrimin e zakonshëm» të tij. Kjo d.m.th.: Marrja e parakohshme e parave nga sigurimi profesional është e mundur, nëse vërtetohet me siguri, që këto para investohen për vendbanim të përdorur personalisht. Nga rezervimi mund të tërhiqet në çdo kohë sikur shitësi ashtu edhe blerësi. Blerja faktike e shtëpisë pra nuk është vërtetuar me siguri të plotë. Tek pasi të keni nënshkruar kontratën e shitblerjes dhe të është bërë regjistrimi në librin e kadastrës mund të tërhiqni paraprakisht parat nga sigurimi i pensionit profesional. Deri atëherë duhet që sigurori ndryshe të 30 000 frangat. Thënë shkurt: Marrja paraprake e parave nga sigurimi i pensionit profesional për pronësi banesore nuk mund të përdoren vetëm për harxhimet e mundshme shtesë, si shembulli bie rezervimi.

Myriam Muff, work, 17.1.2013

Sëmure: Nuk i marr shtesat e fëmijëve?

Unë jam i sëmurë që 3 muaj dhe plotësisht i paaftë për punë. Pasi shefi im ka pajtuar një sigurim të parave ditore në rast sëmundjeje unë marrë 80% të pagës sime. Tani arka barazuese nuk mi paguan shtesat e fëmijëve. A është kjo në rregull?

Po, kjo është në rregull. Punëmarrësit marrin të paguara shtesat e fëmijëve për muajin në të cilin janë sëmurë dhe përfundimisht edhe për tre muaj tjerë. Pastaj sht4sat e fëmijëve paguhen më tej vetëm nëse personi në fjalë merr një pagë nga së paku 585 franga. Kjo do të ishte për shembull e mundur, nëse ju për paaftësinë e plotë merrni 80% nga arka e sigurimit të parave ditore në rast sëmundjeje, ndërsa pjesën tjetër prej 20% ua jep punëdhënësi. Ju merrni vetëm paratë e siguruar ditore dhe jo pagë. Andaj edhe nuk keni të drejtë më tej për shtesat e fëmijëve. Një këshillë e dobishme: Shefi juaj do të mund të siguronte shtesat e fëmijëve në sigurimin kolektiv të parave ditore në rast sëmundjeje. Përndryshe shtesat e fëmijëve janë të siguruar tek sigurimi aksidental.

Heinrich Nydegger, work, 28.2.2013

- Delegacioni nga Zvicra përbëhet nga:**
1. Znj. **Maya Graf**, Kryetare e Këshillit Nacional dhe e Kuvendit Federal të Zvicrës
 2. Z. **Ruedi Lustenberger**, zëvendëskryetari i Parë i Këshillit Nacional Zviceran
 3. Z. **Ueli Leuenberger**, anëtar i Parlamentit Zviceran
 4. Z. **Laurent Favre**, anëtar i Parlamentit Zviceran
 5. Z. **Hansjörg Hassler**, anëtar i Parlamentit Zviceran
 6. Z. **Roland Fischer**, anëtar i Parlamentit Zviceran
 7. Z. **Andy Tschümperlin**, anëtar i Parlamentit Zviceran
 8. Z. **Adrian Amstutz**, anëtar i Parlamentit Zviceran
 9. Znj. **Suzanne Stritt-Schwegler**, shefe e Protokollit, Asambleja Federale
 10. Z. **Claudio Fischer**, shef i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Asambleja Federale
 11. Znj. **Céline Champion Dessibourg**, Zyrtare e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Impressum: **Bellage zu den Gewerkschaftszeitungen** work, area, Événement syndical | **Herausgeber** Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | **Redaktionskommission** A. García, D. Filipovic, E. Sariasslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | **Sprachverantwortlich** Osman Osmani | **Layout** C. Lonati, Unia | **Druck** Ringier Print, Adligenswil | **Adresse** Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch

Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch